



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



BASHKIA SHKODËR

TERRE DES HOMMES
MISIONI NË SHQIPËRI DHE KOSOVË

Nr. 11960 Prot
Shkodër, më 28.8.2023

Nr. 75 Prot
Shkodër, më 28.08.2023

MARRËVESIJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë 28/08/ 2023, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

1. **Bashkia Shkodër**, me adresë: Rruga 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, Shqipëri, përfaqësuar me vendim delegimi Nr.217 datë 11.08.2023 "Për delegim kompetence" nga **Zv.Kryetari z.Onid Bejleri**, këtej e tutje e quajtur "Bashkia".
2. **Terre des hommes, Misioni në Shqipëri**, një fondacion zvicerian me qendër në Lozanë, punon për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa dallim feje, race, gjinie apo përkatësie politike, regjistruar në Gjykatën e Tiranës Shqipëri me vendimin nr 202, datë 22.11.2005, identifikuar me NIPT K62106002A, me adresë: Rruga "Skenderbej", Nd. 6 H. 2, Ap. 17 & 18, Tirana, Albania, përfaqësuar nga Znj. Enkelejda Kallçiu, mbajtëse i dokumentit të identifikimit Nr I26008152F ; këtej e tutje e quajtur "Tdh".

Palët e mësipërme bien dakord për lidhjen e kësaj marrëveshjeje si më poshtë vijon:

NENI 1 **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshje është të përcaktojë angazhimin e ndërsjelltë të palëve dhe rregullimin e bashkëpunimit përgjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje në Bashkinë Shkodër, me qëllim planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve për ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve cilësore me

bazë komunitare për mbrojtjen e fëmijëve/ të rinjve. Fokusi kryesor i angazhimit do të jetë fuqizimi dhe përfshirja sociale e fëmijëve dhe të rinjve në nevojë për mbrojtje, promovimi i të drejtave dhe mirëqënies së tyre, parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të pasigurtë, mbështetja dhe integrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, dhe familjeve të prekura nga migracioni. Objekt i kësaj marrëveshje do të jetë zbatimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të fushës në përputhje me Ligjin "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligjin për Rininë, në përputhje me parimet e reformës së decentralizimit, reformës territoriale/administrative dhe atë të shërbimeve shoqërore.

NENI 2 **Baza Ligjore**

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me:

- a) Ligji Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- b) Ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- c) Ligji Nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar;
- d) Ligji Nr. 18/2017, datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- e) Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- f) Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë";
- g) Ligj Nr. 37/2017 "Kodi i drejtësisë penale për të mitur";
- h) Vendim Nr. 47/2019 "Për miratimin e Strategjisë për edukimin ligjor të publikut 2019-2023";
- i) Udhëzimi Nr. 911, dt 28.12.2018 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të qendrave komunitare shumëdisiplinore";
- j) Udhëzimi Nr. 564, dt 05.10.2022 "Për miratimin e standarteve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktime apo dëshmitarë të abuzimit seksual apo formave më të rënda të dhunës";
- k) VKB nr.75, date 27.12.2022 "Për miratimin e planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025";
- l) VKB nr.19, date 20.07.2023 " Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij në bashkinë Shkodër".

NENI 3 **Parimet e Bashkëpunimit**

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Palët sigurojnë se gjatë veprimitarisë së tyre do të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë, mos diskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

dhe fëmijës, me synim promovimin e mirëqënies dhe zhvillimit të fëmijëve, si dhe të rinjve në Bashkinë Shkodër. Marrëveshja synon të koordinojë zhvillimin e programeve me bazë komunitare dhe të specializuara për familjet në nevojë, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë në rrezik mbrotje. Kjo marrëveshje garanton mbështetjen e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor, si dhe atë të kujdesit shoqëror për familjet në nevojë.

NENI 4

Objektivat specifike të kësaj marrëveshje

- 4.1 Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare, shoqërore dhe edukative i fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në rrezik për migrim të pasigurtë apo të prekur nga migracioni, si dhe fëmijëve, të rinjve dhe familjeve vulnerabël në rrezik trafikimi.
- 4.2 Përmirësimi i aksesit në shërbime të specializuara për fëmijët, të rinjtë viktime ose dëshmitarë të abuzimit seksual apo forma më të rënda të dhunës.
- 4.3 Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve komunitare me në fokus fëmijët, të rinjtë dhe aksesit në shërbime cilësore për fëmijët, të rinjtë dhe familjet vulnerabël apo në rrezik.
- 4.4 Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve në nevojë nëpërmjet procesit të përfshirjes së tyre në aktivitete që nxisin kreativitetin dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në vendimmarrje lokale.
- 4.5 Menaxhimi i rasteve dhe mbështetja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në bashki, Punonjësve të Mbrojtjes së fëmijëve në njësitë administrative, për të garantuar parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve/ të rinjve të rrezikuar dhe prekur nga abuzimi, dhuna, neglizhimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe në konflikt me ligjin, në përputhje me planin individual të ndërhyrjes për fëmijën dhe procesin ndërsektorial të menaxhimit të rastit.
- 4.6 Parandalimi i abuzimit të fëmijëve/ të rinjve, shfrytëzimit, trafikimit apo ekspozimit ndaj migracionit të pasigurtë si dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve/ rinjve, vlerave kulturore e sociale.
- 4.7 Modelimi dhe ngritja e Njesisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NJVNR) dhe forcimi i kapaciteteve teknike të stafit për ofrimin e shërbimeve lidhur me vlerësimin e nevojave dhe referimin, për grupe vulnerabël në komunitet, me fokus të veçantë në njësitë administrative.
- 4.8 Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të ofruesve të shërbimeve dhe disiplinave të ndryshme për të ofruar dhe menaxhuar shërbime efektive që aksesohen dhe mbështesin fëmijët/ të rinjtë në rrezik apo vulnerabël si dhe për të përmirësuar mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve.
- 4.9 Planifikimi efektiv i shërbimeve shoqërore vendore në kuadër të reformës së decentralizimit.

NENI 5
Angazhimet e palëve

5.1 Bashkia merr përsipër:

1. Të promovojë të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në përputhje me legjislacionin në fuqi, strategjitë përkatëse dhe standardet e shërbimeve shoqërore dhe ato të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve.
2. Të planifikojë shërbimet shoqërore në Bashkinë Shkodër, në mënyrë të koordinuar me aktorët relevant dhe me pjesëmarrje të komunitetit.
3. Të marrë pjesë në mënyrë të rregullt në takimet periodike për rishikimin e planeve dhe ecurinë e punës.
4. Të përcaktojë një punonjës nga Bashkia, i cili do të angazhohet drejtpërdrejtë dhe do të jetë pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe planit të aktiviteteve për vitin 2023-2026 dhe të raportojë në bashki (në drejtorinë përgjegjëse) për realizimin e këtij projekti.
5. Të sigurojë koordinimin dhe komunikimin mbi këtë marrëveshje midis drejtorive të bashkisë dhe institucionet në varësi të saj, me anë të pikës së kontaktit.
6. Të udhëheqë bashkëpunimet me aktorë relevant të shoqërisë civile, sektorit privat dhe atij publik në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe integritimit social të familjeve të identifikuar.
7. Të sigurojë hapësira për ofrimin e shërbimeve për të rinjtë dhe fëmijët, të cilat garantojnë respektimin e standarteve të shërbimeve.
8. Të angazhohet në zhvillimin dhe mbështetjen e shërbimit me bazë komunitare pranë qendrës komunitare "Për familjen" nr. 5 të bashkisë dhe qendrës komunitare "Për familjen" Gur i Zi, në njësinë administrative Gur i Zi
9. Të sigurojë mirëmbajtjen e qendrave përfshirë, pagesën e energjisë elektrike dhe të ujit, pastrimin si dhe të kujdeset për mirëmbajtjen fizike të qendrës.
10. Të mundësojë që stafi i qendrave komunitare të trajnohet për ofrimin e shërbimeve komunitare, të marrë pjesë në mënyrë të rregullt në një proces mentorimi dhe mbështetje të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve përgjatë punës, të mundësojë punën në komunitet të stafit për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve.
11. Të sigurojë pjesëmarrjen e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik, Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki dhe në njësitë administrative, të punonjësve socialë ofrues të shërbimeve të bashkisë në punën koordinuese dhe atë në terren për identifikimin e hershëm të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të prekur nga migracioni apo në rrezik për migrim të pasigurtë, fëmijëve dhe familjeve vulnerabel në rrezik trafikimi, si dhe fëmijët/të rinjtë në konflikt me ligjin për referimin e tyre në shërbime relevante të zonës.
12. Të sigurojë pjesëmarrjen e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik si dhe Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki dhe në njësitë administrative, të punonjësve socialë ofrues të shërbimeve të bashkisë në trajnimet që do të organizohen për ngritjen e kapaciteteve profesionale.

13. Të aplikojë mbledhjen e të dhënave të lidhura me menaxhimin e rastit dhe shërbimeve të ofruara për to duke garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave duke marrë masa paraprake që të dhënat të mbledhen dhe ruhen sistematikisht edhe në forma të tjera përveç sistemit database.

5.2 Tdh merr përsipër:

1. Të zhvillojë dhe të zbatojë projekte në përputhje me qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje.
2. Të mbështesë ofrimin e paketës së shërbimeve të integruara me bazë komunitare pranë qendrës komunitare "Për familjen" nr. 5 të bashkisë dhe qendrës komunitare "Për familjen" në njësinë administrative Gur i zi.
3. Të mbështesë një program të aktivizimit të grupeve rinore në bashkëpunim me shërbimet sociale në bashki me fokus fuqizimin e të rinjve për pjesëmarrje aktive në procese vendimarrjeje që lidhen me mirëqënien e tyre për periudhën 2023- 2026, sipas planit të aktiviteteve.
4. Të mbështesë ofrimin e shërbimeve të specializuara (One Stop Center) për fëmijët viktime ose dëshmitarë të abuzimit seksual ose çdo forme të rëndë dhune.
5. Të realizojë ngritjen e kapaciteteve për profesionistët që punojnë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për të rinjtë, përfshirë ato për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi, në konflikt me ligjin apo migracioni i pasigurtë si dhe stafin e njësisë administrative përmes trajnimeve formale dhe mbështetjes së profesionistëve.
6. Të mbështesë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të vazhdueshme për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në parandalimin e abuzimit të fëmijëve/ rinjve, shfrytëzimit, trafikimit apo ekspozimit në migracion të pasigurtë.
7. Të ofrojë asistencë teknike për planifikimin efektiv të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Shkodër.
8. Të mbështesë planet individuale të riintegrimit dhe aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave për familjet e fëmijëve dhe të të rinjve vulnerabël në mënyrë që të kenë mundësitë minimale për të siguruar mirëqënien e fëmijëve dhe të të rinjve.
9. Të mbështesë grupet e edukatorëve bashkëmohatar në aktiviteteve ndërgjegjësuese që ato përzgjedhin dhe funksionimin e tyre efektiv duke u trainuar dhe informuar mbi mobilizimin e të rinjve, lidhshmërinë, duke zhvilluar aftësitë për jetën dhe aftësitë për organizimin e nismave dhe aktiviteteve me bashkëmohatarët.
10. Të mundësojë aktivitete të rregullta psikosociale nga animatorë të trajnuar për të lehtësuar integrimin e fëmijëve/ të rinjve në shkollë dhe komunitet duke rritur aftësitë e tyre të reziliencës dhe aftësitë për jetën.
11. Të mbështesë grupet komunitare të të rriturve, të edukatorëve bashkëmohatar të fëmijëve dhe të rinjve, në aktiviteteve ndërgjegjësuese që ato përzgjedhin dhe funksionimin e tyre efektiv, duke u trainuar dhe informuar mbi mobilizimin e këtyre grupeve, lidhshmërinë, duke zhvilluar aftësitë për jetën dhe aftësitë për organizimin e nismave dhe aktiviteteve për ndryshim social.

12. Të mbështesë Bashkinë për modelimin dhe ngritjen e Njësisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NjVNR), dhe të forcojë kapacitetet e tyre teknike për ofrimin e shërbimeve lidhur me vlerësimin e nevojave dhe referimin, për migrantët e kthyer dhe personat në rrezik të migrimit të pasigurt, si dhe grupe të tjera vulnerabël në komunitet, me fokus të veçantë në njësitë administrative.
13. Të përcaktojë një punonjës nga organizata Tdh, i cili do të angazhohet drejtëpërdrejtë dhe do të jetë pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
14. Të rishikojë dhe përditësojë planin e aktiviteteve në çdo vit kalendarik.

NENI 6

Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 6.1 Kjo marrëveshje lidhet duke filluar nga dita e nënshkrimit të saj dhe do të jetë efektive për një periudhë 3 vjeçare (2023-2026).
- 6.2 Zgjatja dhe Rishikimi i mëtejshëm do të jetë objekti i diskutimit të palëve të Marrëveshjes.

NENI 7

Zbatimi i marrëveshjes

- 7.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në koordinimin e të gjitha veprimeve dhe nismave që do të garantojnë përmbushjen dhe realizimin me sukses të saj.

NENI 8

Përfundimi i marrëveshjes

- 8.1 Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:
 - a) mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;
 - b) shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
 - c) palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes.
- 8.2 Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.
- 8.3 Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

9.1 Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.

NENI 10
Dispozita të fundit

10.1. Palët përgjigjen reciprokisht për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj duke punuar për realizimin e veprimtarive të përbashkëta.

10.2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dy palët.

NENI 11
Hyrja në fuqi

11.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

11.2 Marrëveshja u hartua në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale e cila pasi u lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR
Z. Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
Z/KRYETAR
Onid BEJLERI



PËR
TERRE DES HOMMES, MISSIONI NË
SHQIPËRI

DREJTORE PËR SHQIPËRINË

Zj. Enkelejda KALLÇIU

